REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.11.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinioni dhe raporti i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari mbështetur nga Fejzullah Fejza (Udhëheqës i ekipit), Donjetë Dreshaj, Nora Rashiti dhe Florë Berisha.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit 8
2 Pasqyrat vjetore financiare 9
3 Rekomandimet e vitit paraprak 12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 13
5 Sistemi i auditimit të brendshëm 31
6 Konkluzioni i përgjithshëm 33
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 35
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak 37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore (PVF-të) për vitin 2012 për Ministrinë e Shëndetësisë (MSH). Unë do të doja të falënderoja Ministrin e MSH-së dhe stafin e tij për ndihmën e dhënë gjatë procesit të auditimit.

Sektori i shëndetësisë aktualisht është duke ju nënshtruar reformave domethënëse. Për t'i dhënë Ministrisë mbështetje në adresimin e këtyre reformave dhe për t'i ngritur proceset ekzistuese të kontrollit, ZAP poashtu ka bërë tri auditime tjera në sektorin e shëndetësisë – një auditim menaxherial të Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale (AKPM), një auditim të procedurave të prokurimit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe një auditim të pjesëshëm të furnizimit dhe menaxhimit me barna. Këto janë subjekt i raporteve të ndara.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinioni

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Opinioni i AP-së jep pikëpamje mbi vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinioni i AP-së është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat vjetore Financiare prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe stoqet është jo i plotë. **(SNISA 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Auditimi ynë për vitin 2012 është një reflektim i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti i MSH-së përgjatë vitit. Konkluzioni ynë i përgjithshëm në lidhje me menaxhimin financiar është se:

Ne ishim në gjendje të marrim siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në vetëm një numër të fushave dhe kemi identifikuar dobësi në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar.

Konkluzioni i dalur nga auditimi i procesit të furnizimit të barnave është se duhet të përmirësohet procesi në përgjithësi duke filluar nga planifikimi i kërkesave për barna dhe material shpenzues nga lista esenciale, përgatitja e vet listës, furnizimi e deri te menaxhimi i stoqeve dhe shpërndarja e tyre. Ne konsiderojmë se ky përmirësim do ndihmonte në masë të madhe funksionalizimi i divizioneve në kuadër të departamentit farmaceutik (DF) dhe një bashkëpunim më i ngushtë i DF me instritucionet shëndetësore.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin menaxhmentin e MSH-së në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe aktiviteteve operacionale. Duke pasur parasysh që struktura organizative e paraparë në kuadër të procesit të reformimit akoma nuk është adaptuar, rekomandimet ja kemi adresuar Ministrit. Mirëpo pa adaptimit të saj, përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve të ndërlidhura me institucionet vartëse do të duhej të bartet tek personat dhe organet përgjegjëse. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra për vitin 2011 dhe vetëm një pjesë e këtyre janë adresuar duke rezultuar me vazhdimin në 2012 të dobësive të kontrollit, të identifikuara më parë.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të MSH-së dhe njësive të saj dhe të gjeturat tona në lidhje me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Auditimin e brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore janë që Ministri duhet të siguroj:

Pasqyrat vjetore financiare

- Plani i prodhimit të pasqyrave 2013 ta inkorporojë shqyrtimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti të me theks të veçantë në plotësinë dhe saktësinë e informatave brenda PVF-ve. Duhet të bëhet një shqyrtim specifik për të konfirmuar nëse shpenzimet që duhet të kapitalizohen janë llogaritur saktë.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar - duke iu dhënë proritet çështjeve sipas rëndësisë së tyre;
- Proceset ekzistuese të buxhetit të rishikohen për të përcaktuar çfarë përmirësimesh mund të bëhen për të siguruar rritjen e nivelit të ekzekutimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, MSH duhet që në mënyrë proaktive t'i monitorojë shpenzimet kapitale, të kërkojë në mënyrë aktive që t'i identifikojë dhe adresojë barrierat në përmirësimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit. Vemëndje e veqantë duhet ti kushtohet zbatimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe programit për Investime Publike (PIP);
- Të zbatohet një planifikim efektiv të projekteve për t'u siguruar që janë përmbushur të gjitha kërkesa e raportimit të jashtëm. Ngjashëm, duhet të inkorporohet një shqyrtim rigoroz i udhëzimeve të MFK-së si një element kyç në planin e punës së departamentit të financave gjatë vitit 2013;
- AKPM të zbatojë procedura efektive të harmonizimeve në baza mujore për të gjitha llojet e të hyrave;
- QKUK-në dhe Menaxhmentet e Spitaleve Regjionale të marrin në konsideratë zbatimin e një softver efektiv i cili i adreson dobësitë ekzsituese në regjistrimin manual. Në afat të shkurtër, duhet të merren në konsideratë shtimet potenciale të kontrolleve manuale mbi të hyrat si shtimi i kontrollimeve të mbikqyrjes, validimi i mostrave të të hyrave të paguara nga pacientët individualë etj, për ta konfirmuar plotësinë e të hyrave;
- Rastet e identifikuara në lidhje me procedurat e prokurimit janë rishikuar dhe shkaqet prapa deshtimeve janë përcaktuar. Më tujte kontrollet rreth aktivitetet e prokurimit janë përmirësuar për të siguruar që ndarja jo e duhur e detyrave është evituar, ofertat më konkuruese janë pranuar, është arritur vlera e duhur për para, vendimet e prokurimit janë bërë në kohën e duhur dhe pagesat janë bërë saktë.
- Përdorimi i produkteve të cilësisë së ulët është rishikuar dhe janë përcaktuar veprime të kërkuara për të siguruar që janë pranuar zëvendësime të duhura brenda afatit adekuat dhe që furnizimet joadekuate nuk janë përdorur.

Ndëshkimet e kontratave dhe aplikimi i tyre duhet të shqyrtohen si pjesë e këtij vlerësimi;

- Stafi financiar i MSH-së të punojë me SR Gjakovë për ta përmirësuar raportimin e prokurimit, me QKUK-në për të siguruar që rreziqet e shoqëruara me sigurimin e ekzekutimit janë monitoruar dhe menaxhuar në mënyrë efektive, me SR Prizren dhe SR Pejë për t'i përmirësuar pranimet e mallrave. Duhet të shqyrtohet menaxhimi i stoqeve për të siguruar që janë zbatuar proceset efektive në sigurimin e kontrollit efektiv edhe përdorimit të barnave;
- Të gjitha njësitë po zbatojnë kontrolle efektive mbi kujdestaritë me harmonizime të rregullta në mes të punës gjatë kujdestarive dhe pagesave të bëra dhe/apo për të siguruar që pagesat e gatishmërisë janë autorizuar nga menaxhmenti. Vetë-autorizimi i kujdestarive duhet të ndalet;
- Janë zbatuar kontrolle adekuate rreth subvencioneve dhe transfereve të cilat përfshijnë konfirmim nga pacientët mbi dëshmitë në dispozicion për t'i mbështetur pagesat – së paku në bazë të mostrave;
- Një aktivitet specifik është përfshirë në planin e punës të departmentit të financave për vitin 2013 për të siguruar një harmonizim gjithëpërfshirës në mes të regjistrit të pasurive të MSH-së dhe atyre të njësive të saj dhe për të zbatuar një proces të vazhdueshëm të harmonizimit për të siguruar mirëmbajtjen e harmonizimit;
- Të shqyrtohen arsyet për nivelin ekzistues të obligimeve të papaguara dhe një plan veprimi është zhvilluar me qëllim të zvogëlimit të këtij niveli.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Komiteti i Auditimit të zbatojë në mënyrë efektive detyrat dhe përgjegjësitë e tij në vitin 2013 me theks të veçantë në të siguruarit që menaxhmenti ta zhvilloj cilësinë e NJAB-së dhe të implementojë aranzhime efektive për adresimin me kohë të rekomandimeve të saj.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë(MSH) të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Ministrinë e Shëndetësisë . Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuara në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme, sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat deri në atë masën që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse te të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në funksionimin e sistemeve dhe procedurave.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administratvi (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkludojmë se MSH i kishte përgatitur Pasqyrat Vjetore Financiare në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

Përshkrimi

MSH në kuptimin formal kishte respektuar kërkesat aktuale të raportimit si në vijim:

- Pasqyrat Vjetore Financiare janë pergatitur brenda kornizës kohore me datën 31/01/2013 dhe janë dorëzuar në MF;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar; dhe
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Të gjeturat dhe rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financare

Konkluzioni i përgjithshëm

Pasqyrat financiare të MSH-së kishin një numër gabimesh. Pavarësisht sugjerimeve për përmirësimin e tyre, të bëra edhe në raportin tonë mbi PVF-të e vitit 2011 dhe memon e vitit 2012 në lidhje me pasqyrat financiare 9 mujore, nuk është arritur konsolidimi i plotë i të gjitha informatave financiare relevante.

Përshkrimi

Gjatë procesit të auditimit, ne kemi identifikuar një numër gabimesh në PVF të cilat kërkonin përmirësime. Këto përfshijnë:

- Mos konsolidimin e plotë të të gjitha informatave financiare të nevojshme. PVF-të e MSH-së nuk i përmbajnë të gjitha informatat financiare të njësive raportuese. Stoqet e SR në Pejë (vlera 97,389.76 €) dhe SR në Gjakovë (vlera 132,927€) nuk janë shpalosur, dhe PVF-të në mënyrë signifikante e nëndeklarojnë vlerën e pasurive fikse për 21,247,423€;[1]
- Mbideklarimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për shkak të të përfshirjes së shpenzimeve në lidhje me servisimin e pajisjeve mjekësore të cilat është dashur të kapitalizohen;

Ne kemi dhënë rekomandime në vitin 2011 për të përmirësuar shpalosjet e Informacioneve Financiare në PVF dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese të kërkuara. Këtë çështje e kemi ri-theksuar edhe në memon mbi pasqyrat financiare 9 mujore të vitit 2012. Mirëpo, këto rekomandime nuk janë marrë parasysh tërësisht nga menaxhmenti.

Duke i pasur parasysh këto më lart – Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, kur janë dorëzuar pasqyrat, nuk ka dhënë një vlerësim të saktë të cilësisë së PVF-ve.

[1] Vlera neto e pasurive kapitale (me vlerë mbi 1000€) ishte 232,604,576€, ndërsa në PVF është shpalosur vlera prej 211,357,153€.

Të gjeturat dhe rekomandimet

1. Çështja - Procesi i hartimit të PVF-ve – Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura	Pasqyrat Vjetore Financiare dhe letrat shoqëruese të punës nuk ishin subjekt i një niveli të duhur të rishikimit nga menaxhmenti para se të pranoheshin nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo ka rezultuar në një numër gabimesh dhe lëshimesh të identifikuara në pasqyrat financiare të cilat kanë mundur të nënvizoheshin nga shqyrtimi i menaxhmentit.
Rreziku	Pasqyrat Vjetore Financiare nuk janë të plota dhe ekziston rreziku për Opinion të Kualifikuar apo Theksim të Çështjes. Mos prezantimi i vlerës së saktë të pasurive mund të rezultojë në një keqkuptim të pozitës financiare të MSH-së dhe në mundësinë që të nëndeklarohen kërkesat buxhetore në të ardhmen. Publikimi i PVF-ve me cilësi të ulët do ta zvogëlojë efektivitetin e PVF-ve në promovimin e llogaridhënies dhe do të reflektojë negativisht në MSH.
Rekomandimi 1	Ministri duhet të sigurojë që plani i prodhimit të pasqyrave 2013 ta inkorporojë shqyrtimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti me theks të veçantë në plotësinë dhe saktësinë e informatave brenda PVF-ve. Duhet të bëhet një shqyrtim specifik për të konfirmuar nëse shpenzimet që duhet të kapitalizohen janë llogaritur saktë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë Pasqyrat vjetore Financiare prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë dhe stoqet është jo i plotë. Kjo sipas SNKSP nuk ndikon në asnjërën nga dy pasqyrat kryesore financiare **(SNISA 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).**

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Megjithëse MSH i ka marrë në konsideratë rekomandimet tona të vitit të kaluar, shumica e tyre ka mbetur pa u implementuar tërësisht. Kjo ka ndikuar që dobësitë e identifikuara më herët të vazhdojnë edhe në vitin 2012.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit të PVF-ve të vitit 2011 kishte rezultuar në (12) rekomandime kryesore. MSH kishte aprovuar një plan veprimi për adresimin rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2012, dy (2) nga rekomandimet ishin implementuar plotësisht, katër (4) pjesërisht, dhe gjashtë (6) të tjera nuk janë implementuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Të gjeturat dhe rekomandimet

2. Çështja - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti – i rëndësishëm

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit paraprak janë implementuar nga menaxhmenti.

Rreziku Vazhdimi i dobësive të kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare ka rezultuar në:

- Prezantim jo të saktë të informatave në pasqyrat vjetore financiare;
- raportime jo të sakta financiare nga njësitë e ministrisë;
- menaxhim jo të mire të investimeve kapitale, dhe prokurime jo efikase;
- menaxhim jo të mire të depos qëndrore dhe barnave; dhe
- menaxhim joefikas të detyrimeve.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it, me anëtar të stafit përgjegjës të identifikuar - duke iu dhënë proritet çështjeve sipas rëndësisë së tyre.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i MSH-së për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky mund të jetë aktivitet monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo niveli më i ulët i kontrolleve operative. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të zbatuara nga menaxhmenti. Gjatë auditimit ne kemi marrë në konsideratë kërkesat e MFK-së.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Megjithëse MSH e ka realizuar buxhetin në një nivel të arsyeshëm, pos për investimet kapitale, mbetet akoma vend për zhvillim të mëtejm të procesit buxhetor. Në veçanti, barrierat në shpenzimet për investime kapitale në kohë të ndryshme duhet të identifikohen dhe adresohen. Në lidhje me këtë, theks i veçantë duhet t'i vihet zbatimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe PIP ashtu siç është parashikuar.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për MSH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Totali:	**88,588,425**	**92,570,243**	**87,305,025**	**79,903,318**	**74,804,338**
Granti i Qeverisë-Buxheti	84,633,335	**86,472,136**	82,714,458	76,188,739	69,712,526
Të bartura nga viti paraprak[3] –	-	876,789.08	841,961	770,891	832,572
Të hyrat vetanake[4]	3,955,090	3,955,090	3,720,719	2,314,617	2,845,085
Donacionet e Jashtme	-	1,266,228	27,885.98	629,071	1,414,155

Buxheti final karshi buxhetit fillestar është rritur për 3,981,818€. Kjo e reflekton rritjen e grantit të qeverisë për 1,838,801€, përfshirjes në buxhet te të hyrave nga viti i kaluar në vlerë 876,789€ si dhe donacioneve prej 1,266,228€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Totali:	**88,588,425**	**92,570,243**	**87,305,025**	**79,903,318**	**74,804,338**
Pagat dhe Mëditjet	39,722,448	42,700,138	42,527,654	38,827,166	32,868,160
Mallrat dhe Shërbimet	30,901,904	31,304,747	29,158,546	29,418,681	27,638,891
Komunalitë	3,514,073	3,937,672	3,871,170	3,292,171	3,342,579
Subvencionet dhe Transferet	2,000,000	2,850,591	2,841,471	2,206,483	2,955,422
Investimet Kapitale	12,450,000	11,777,095	8,906,471	6,158,817	7,999,286

Shpenzimi i përgjithshëm tregon rritje signifikante në shumicën e kategorive ekonomike që nga viti 2010 në veçanti te ajo për paga dhë mëditje ku rritja është rreth 29%. Ky është rezultat i drejtpërdrejtë i politikës së qeverisë për ta rritur numrin e profesionistëve mjekësorë të punësuar. Rritja në buxhetin final reflektohet nëpër të gjitha kategoritë pos te investimet kapitale dhe:

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

[3] Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

[4] Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit është 94%, apo 97% nëse i përjashtojmë investimet kapitale ku ekzekutimi i buxhetit është 76%;
- Realizimi te mallrat dhe shërbimet është një nivel më poshtë se buxheti fillestar i cili rrjedhimisht është rritur;
- Për investime kapitale 54% e buxhetit janë shpenzuar në tremujorin e fundit dhe niveli i përgjithshëm i shpenzimit reflekton vonesa procedurale - leje ndërtimi (kërkesat nuk ishin parashtuar me kohë), revidimi i projekteve kapitale, si dhe mungesa e kapaciteteve profesionale për përcjelljen e të gjitha projekteve në zhvillim.

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Te hyrat vetanake	3,955,090	3,955,090	3,925,511	3,838,143	3,692,338

MSH ka rritje të vazhdueshme te të hyrave nga viti në vit si reflektim i shtimit të aktiviteteve në gjithë sektorin shëndetësor e posaçërisht tek AKPM ku kishte shtim të aprovimeve për liçenca dhe leje të importit të produkteve dhe pajisjeve mjekësore etj.

Të gjeturat dhe rekomandimet

3. Çështja - Ekzekutimi dhe planifikimi i buxhetit – Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura

Megjithëse arsyet për nënshpenzim karshi buxhetit në përgjithësi mund të shpjegohen, niveli aktual i ekzekutimit mund të përmirësohet, në veçanti ai në lidhje me investimet kapitale. Duhet mëtej t'i jepet konsideratë raportit në mes të buxhetit dhe realizimit për mallra dhe shërbime.

Gjatë vitit, projektet kapitale nuk janë zhvilluar në pajtueshmëri me: KASH-in, buxhetin e miratuar dhe PIP-in. Një shembull i mospërmbushjes së qëllimeve të KASH-it, buxhetit të miratuar dhe PIP-së është proporcioni relativ i investimeve në mes të pajisjeve mjekësore dhe servisimit të pajisjeve mjekësore.

Rreziku	Ekzekutimi i varfër i buxhetit do të rezultojë në përdorim joefikas të burimeve në sektorin publik dhe do ta zvogëlojë zbatimin efektiv të planeve të shpenzimeve në organizatat buxhetore individuale.
Rekomandimi 3	Ministri duhet të siguroj rishikimin e proceseve ekzistuese të buxhetit për të përcaktuar çfarë përmirësimesh mund të bëhen për të siguruar rritjen e niveleve të ekzekutimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, MSH duhet që në mënyrë proaktive t'i monitorojë shpenzimet kapitale, të kërkojë në mënyrë aktive që t'i identifikojë dhe adresojë barrierat në përmirësimin e niveleve të ekzekutimit të buxhetit. Duhet t'i vihet theksi zbatimit të KASH-it dhe PIP-it sipas parashikimeve.

4.3 Kërkesat aktuale të raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

MSH i ka përmbushur shumicën e kërkesave aktuale për raportim të jashtëm pos planeve të prokurimit për dy njësi të saj. Megjithatë, mbetet mundësia të aplikohen vetëvlerësimet e MFK-së për t'i vlerësuar dhe përmirësuar kontrollet e brendshme në mënyrë prokative aty ku duhet.

Përshkrim

Përveç përgatitjes dhe dorëzimit me kohë të PVF-ve, MSH kishte përmbushur edhe kërkesat e mëposhtme aktuale të raportimit pos përjashtimeve të cekura:

- Kërkesat Buxhetore ishin bërë më kohë;
- Raportet tremujore ishin përgatitur me kohë dhe janë dërguar tek MF duke përfshirë raportin nëntëmujor financiar;
- Draft Planet e prokurimit dhe planet finale (me përjashtim të QKUK-së, dhe SR të Gjakovës) ishin bërë me kohë dhe të njejtat ishin dërguar në AQP; dhe
- Raportimet për obligimet e papaguara ishin bërë për çdo tremujor në MF.

Përderisa nuk është plotësuar kërkesa formale – vletëvlerësimi i MFK-së

Të gjeturat dhe rekomandimet

4. Çështja - Kërkesat e jashtme të raportimit - Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura	Kërkesat për raportim të jashtëm nuk janë përmbushur plotësisht dhe mbetet potenciali për t'i zhvilluar vetëvlerësimet e rekomanduara karshi udhëzimeve të MFK-së.
Rreziku	Mungesa e planeve efektive të prokurimit mund ta zvogëlojë efektivitetin e proceseve të prokurimit. Mosadresimi i udhëzimeve të MFK-së mund të rezultojë në mos identifikimin dhe adresimin e dobësive ekzistuese në kontroll.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të të zbatojë një planifikim efektiv të projekteve për t'u siguruar që janë përmbushur të gjitha kërkesa e raportimit të jashtëm. Ngjashëm, duhet të inkorporohet një shqyrtim rigoroz i udhëzimeve të MFK-së si një element kyç në planin e punës së departamentit të financave gjatë vitit 2013.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Edhe pse të hyrat janë relativisht të ulëta në krahasim me shpenzimet, është e rëndësishme që të zbatohen kontrolle të shtuara për ta mbështetur menaxhimin më të mirë. Këto përfshijnë procese të përmirësuara të harmonizimit dhe fokus më të madh në plotësinë e dëftesave. Çështja e fundit mund të mbështetet duke e zbatuar një zgjidhje softverike por poashtu mund të adresohet përmes kontrolleve të shtuara manuale.

Përshkrimi

MSH realizon të hyra nga një rang i gjerë burimesh duke përfshirë: participimet për shërbimet e ofruara; licencat e ndryshme për produkte mjekësore dhe artikuj tjerë; qiranë e objekteve publike; tarifat nga parkingu; banderolat; çertifikatat mjekësore dhe gjobat nga inspektoratet. Të hyrat vetjake janë përdorur për t'i financuar pagat dhe mëditjet.

5. Çështja - Evidencat për të hyrat nga banderolat në Agjensinë Kosovarë të Produkteve Mjekësore (AKPM) – Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Gjatë vitit 2012 AKPM nuk kishte mbajtur evidenca të sakta për të hyrat si dhe nuk kishte bërë barazimet e rregullta me pasqyrat e bankave. Për vendimarrje dhe qëllime të raportimit është mbështetur në shënimet e SIMFK, prandaj nuk i ka adresuar variacionet në mes të të hyrave të ngarkuara dhe atyre të mbledhura. Shënimet e thesarit tregojnë që të hyrat nga banderolat për vitin 2012 ishin 117,771€ (që tregojnë se janë shitur 16,824,565 njësi banderolash), përderisa zyra për banderola thotë se ishin shtypur 22,231,917 banderola që janë barazi me të hyra prej 155,622€, një diferencë prej 37,851€ apo 32% e të hyrave të pranuara.

Rreziku Mungesa e harmonizimeve në lidhje me të hyrat përkatëse mund të rezultojë në shpërdorim të të hyrave dhe do ta zvogëlojë efektivitetin e proceseve të kontrollit të buxhetit.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë që AKPM-ja të zbatojë harmonizime efektive në baza mujore nëpër të gjitha rrjedhat e të hyrave.

6. Çështja - Mungesë e një softueri për të hyrat - Prioriteti -I rëndësishëm.

E gjetura Sistemet ekzistuese manuale për regjistrimin e të hyrave në QKUK dhe Spitalet Regjionale kanë dobësi të kontrolleve. Për shembull, mungesa e evidencave për pagesat nga pacientë në protokolle në disa klinika sugjeron që të hyrat e regjistruara nuk janë të sakta, pasi kemi identifikuar dallime në mes të deftesë-pagesave dhe të dhënave nëpër protokolle.

E gjetura Sistemi manual i evidentimit të të hyrave mund të manipulohet gjë që rezulton me mosmbledhjen e të hyrave të duhura. Kjo poashtu mund të rezultojë në nëndeklarimin e të hyrave potenciale në projektimet e ardhshme të buxhetit.

Rekomandimi 6 Ministri duhet ta udhëzojë QKUK-në dhe Spitalet Regjionale të konsiderojnë mundësinë për të zbatuar një softuer efektiv i cili i adreson dobësitë ekzsituese në regjistrimin manual. Në afat të shkurtër, duhet të merren në konsideratë shtimet potenciale të kontrolleve manuale mbi të hyrat si shtimi i kontrollimeve të mbikqyrjes, validimi i mostrave të të hyrave të paguara nga pacientët individualë etj. për ta konfirmuar plotësinë e të hyrës.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Përderisa menaxhmenti i MSH-së e ka të qartë rëndësinë e funksionimit të kontrolleve efikase në fushën e shpenzimeve, dobësi të theksuara ekzistojnë në ketë fushë. Këto dobësi lidhen pjesërisht me prokurimin por edhe tek shpenzimet tjera, paga dhe mëditje, dhe subvencione e transfere.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në ketë seksion të raportit janë përfshirë të gjitha shpenzimet që i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Shpenzimet e buxhetuara që i nënshtrohen procesit të prokurimit ishin në vlerë prej 38,065,016€, prej të cilave janë shpenzuar 35,436,995€ apo 93%.

Testimet tona në këtë fushë të shpenzimeve përfshijnë ekzaminimin e 139 pagesave (lëndëve) që kanë shkuar përmes procedurave të prokurimit të cilat arrijnë vlerën prej 14,194,950€.

Përveq kësaj ne kemi kryer edhe auditime specifike për procedurat e prokurimit në QKUK dhe për procesin e blerjes dhe menaxhimit të barnave. I pari ka rezultuar me një raport të veçantë të auditimit, ndërsa i dyti me një memo. Poashtu kemi bërë edhe auditimin e menaxhimit të aktiviteteve financiare dhe operative të AKPM-së. Ky auditim gjithashtu ka rezultuar me një raport të veçantë të auditimit.

7. Çështja - Procedurat e prokurimit– Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura

Janë identifikuar një numër i dobësive në procedurat e prokurimit duke përfshirë:

Kontrata për dizajnimin e projektit "Ndërtimi i Rezervarit të Ujit të Pijshëm" në SR i Prizrenit (vlera e kontratës së ndërtimit ishte 92,141€), ishte mbështetur vetëm në marrëveshje gojore e jo kontratë. Kjo shumë është përfshirë në kontratën për mbikëqyrje të kontratës. Kontrata për mbikqyrje i është dhënë Kryetarit të Komisionit për vlerësimin e tenderëve me rastin e përzgjedhjes së operatorit për ndërtimin e rezervarit.

Në SR të Gjakovës, tenderi për "Mirëmbajtjen e higjienës në objektet e Spitalit" ishte kthyer tri herë në rivlerësim nga OSHP-ja pas ankesave të njërit nga ofertuesit. Gjatë rivlerësimit, komisioni vlerësues në procesverbal kishte konkluduar se "komisioni nuk pajtohet me ofertën e OE ankues "MSS" për shkak të vërejtjeve që ky operator kishte në realizimin e kontratave të mëhershme. Por të ndikuar nga vendimet e OSHP- së ishin të detyruar ti japin tenderin OE "MSS.

Në SR të Gjakovës komisioni i vlerësimit të tenderit për "Furnizim me makina-rroba larëse industriale" kishte shpallur fitues OE, pavarësisht që oferta e tij ishte më e shtrenjtë për 11,100€. Oferta më e lirë ishte refuzuar në bazë të specifikave teknike mirëpo edhe tenderuesi fitues nuk kishte specifika për makinat.

Në SR të Pejës, tek prokurimi për 2 kontrata për furnizim me pajisje mjekësore, kërkohej çertifikatata e arritjes së ISO standardeve 9001, 9002 dhe 13485 ose ekuivalentët e tyre. OE fitues nuk e kishin plotësuar këtë kriter.

Rreziku

Cilësia e dobët e porcedurave të prokurimit mund të rezultojë në pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, vlerë të ulët për para si dhe në moszbatimin e kontratave sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të siguroj që janë shqyrtuar rastet e identifikuara në lidhje me procedurat e prokurimit dhe të përcaktojë pse kanë ndodhur dështimet e identifikuar të prokurimit dhe të zbatojë kontrolle të shtuara për t'u siguruar që:

Nuk ka konflikt të interesit gjatë fazave të ndryshme të prokurimit;

Zbatimi i prokurimit siguron që janë pranuar ofertat më konkurruese për të siguruar arritjen e vlerës për para; dhe

Vendimet e prokurimit të bëhen me kohë.

8. Çështja - Nënshkrimi i kontratave –Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura

Më 21/06/2011, MSH kishte lidhur kontratë afatgjatë, me dy OE për për të njëjtin produkt (Cefriaxone 250mg/ml). Për nga çmimi ofertat ishin të barabarta dhe sipas ligjit ekzistues, vendimi për ofertat do të duhej të merrej në bazë të performancës në të kaluarën. Përveç kësaj sasia e parashikuar e furnizimit vjetor me ketë artikull ishte 7,000 njësi, mirëpo furnizimi ishtë bërë me 10,000 njësi nga njëri OE kontraktues.

Me datën 29.08.2012, SR i Prizrenit, kishte nënshkruar kontratën për furnizimin me pajisje të teknologjisë informative në vlerë prej 7,691€ gjë që ishte bërë pas faturimit. Në mungesë të Raportit të Pranimit, e tërë shuma ishte paguar ditën e njejtë, derisa fatura ishte e datës 28.08.2012.

Rreziku

Dy kontrata për artikullin e njëjtë mund të rezultojnë në huti në menaxhimin e furnizimeve si dhe kosto shtesë për MSH-në nëse njëri nga OE-të e konsideron veten më pak të favorizuar se tjetri. Pagesat para marrëveshjes formale kontraktuese mund të rezultojë në gabime të pritshme në kosto, dhe në mospërmbushje të specifikave të vëllimit dhe cilësisë.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të sigurojë se aty ku ofertat e prokurimit janë të ngjashme, Menaxhmenti i MSH-së, duhet të përcaktojë fituesin e tenderit në bazë të referencave apo përvojave eventuale të mëhershme me OE-të dhe poashtu të sigurojë që;

asnjë furnizim i bërë përmes prokurimit formal nuk duhet të paguhet pa ekzistimin e kontratës formale. Çfarëdo devijimi nga kjo qajse duhet të jetë subjekti i shqyrtimit të menaxhmentit për të përcaktuar pse ka ndodhur situata dhe për të identifikuar çfarë kontrolle duhet të shtohen për ta parandaluar përsëritjen e kësaj situate.

9. Çështja - Realizimi i kontratave – Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura

MSH ishte furnizuar me penjë kirurgjik që nuk kanë qenë në përputhje me specifikimet e kontratës. Vlera e këtij furnizimi ishte 116,352€. Pagesat për këto produkte fillimisht ishin shtyer me arsyetimin se të njëjtat nuk janë konform kontratës. Mirëpo këto produkte ishin të domosdoshme për operacione, prandaj furnizimi është përdorur dhe është paguar më vonë.

Nga kodet e dy projekteve në SR të Prizrenit janë paguar mjete për një projekt tjetër. Kjo është bërë pa aplikuar procedurat për transferim të mjeteve[5].

Pagesat për kontratën "Furnizim me material administrativ" kishin tejkaluar vlerën e kontratës për 2,130€. (kontrata ishte 9,475€, ndërsa totali i pagesave 11,605€).

Rreziku

Përdorimi i mallrave të cilësisë së ulët e zvogëlon cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe potencialisht e lë MSH-në të hapur ndaj veprimeve ligjore. Transferimi joformal i buxhetit ndikon negativisht në proceset e konrollit buxhetor dhe i zvogëlon shpenzimet potenciale në fusha tjera.

Rekomandimi 9

Ministri duhet të siguroj që të rishikohet rasti i identifikuar në lidhje me përdorimin e produkteve të cilësisë së ulët dhe të përcaktojë veprimet e nevojshme për të siguruar që janë pranuar zëvendësime të duhura brenda afatit adekuat. Aplikimi i ndëshkimeve të kontratave duhet të shqyrtohen si pjesë e këtij vlerësimi. Proceset që kërkojnë transferimin e fondeve ndërmjet projekteve duhet t'ju ritheksohen stafit.

[5] Mjetet janë për dy pagesat të cilat lidheshin me projektin "Instalimi i sistemit të prodhimit të oksigjenit medicinal dhe renovimi i Kirurgjisë dhe Urologjisë" me vlerë të përbashket prej 40,510€.

10. Çështja - Pagesa të bëra gabimisht – Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura

Ne kemi identifikuar pagesa të bëra jashtë kërkesave kontraktuale pa dëshmi mbështetëse apo që janë të regjistruara në kode të gabueshme ekonomike. Në veçanti:

Në muajin dhjetor MSH kishte paguar paradhënie prej 22,296€[6]. Kjo shumë paraqet 10% të vlerës së kontratave andaj është në kundështim me Ligjin e Buxhetit dhe me rregulloren për mbylljen e vitit fiskal.

MSH dhe SR i Gjakovës kishin kryer pagesa para ofrimit të shërbimeve[7]. MSH kishte paguar 9,900€ për pozicione të cilat ishin përfunduar 3 muaj më vonë. Këtë e vertetonte ditari ndërtimor. Sipas zyrtarëve të MSH-së kishin ndodhur gabime gjatë plotësimit të ditarit ndërtimor. Poashtu përgjatë vitit, SR i Gjakovës kishte shpenzuar 4,654€ për pagesën e stafit të operatorit të kontraktuar për shërbimet e higjienës në kohën e kujdestarive që nuk ishin të parapara me kontratë.

SR i Prizrenit kishte çertifikuar dhe paguar 5 fatura që kapin shumën prej 4,764€ pas skadimit të kontratës[8]. Kjo ishte bërë pa ndonjë miratim paraprak nga menaxhmenti.

Tri pagesa me vlerë totale 34,228€ të cilat MSH i kishte bërë për transportin e artikujve donacion nuk kishin dokumentacion mbështetës.

Katër pagesa në SR të Prizrenit dhe AKPM ishin subjekt i vonesave në realizimin e pagesave[9]

Pesë (5) pagesa[10] për furnizim me derivate ishin ekzekutuar në mungesë të Çmimores së Berzës.

6 Paradhënia ka të bëjë me projektet "Ndërtimi i ashensorit për Klinikën e Kardiokirurgjisë" dhe "Ndërtimi i Ambulancës në Lagjën e Epërme – Rahovec Lot 1"

7 Pagesa e MSH ndërlidhet me projektin "Renovimi dhe sanimi i ashensorëve ekzistues në QKUK dhe ndërtimi i tre ashensorëve" derisa pagesa e SR të Gjakovës me projektin "shërbimet e mirëmbajtjes higjenike".

8 Kontrata ka të bëj me "Furnizimi i Spitalit me material harxhues teknik dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ndërtesave" dhe kishte skaduar me 29.03.2011.

9 Për "Furnizim të spitalit me artikuj ushqimor" kontratë e nënshkruar dhe faturuar në vitin 2006, SR i Prizrenit në vitin 2012 kishte kryer pagesën në vlerë 2,119€; Për "Furnizim me Banderola", kontrata e nënshkruar dhe faturuar në vitin 2009, AKPM e kishte realizuar pagesën në vitin 2012 në vlerë prej 2,742€; për "Furnizim me Ribona për shtypjen e banderolave", kontratë e nënshkruar dhe faturuar në 2010, AKPM kishte realizuar pagesën në vitin 2012 në vlerë prej 3,700€;Tek kontrata "Furnizim me Ribona" e nënshkruar dhe faturuar në prill të vitit 2011, AKPM e kishte realizuar pagesën në vitin 2012 në vlerë prej 9,900€.

MSH ka bërë pagesë prej 41,402€ nga kodi për mallra dhe shërbime gjersa blerja kishte të bëjë me projektin kapital – Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH).

SR Pejë ka paguar për materiale higjienike vlerën prej 15,739€ nga fondet për servisim dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore.

Rreziku Pagesa e avancit në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe pagesat e pa mbështetura nga shërbimet e pranuara janë të parregullta. Pagesat e bëra pa dëshmi të mjaftueshme mund të rezultojnë në atë që shërbimet e pranuara të jenë më pak se sa është pritur dhe të cilësisë së ulët dhe që MSH të paguajë kosto më të lartë se sa që është e nevojshme apo e pritshme. Regjistrimi dhe kodifikimi i gabuar i shpenzimeve shkakton pasqyrim jo të drejtë të tyre në PVF dhe ka ndikim negativ në kontrollin buxhetor.

Rekomandimi 10 Ministri duhet t'i shqyrtojë rastet e identifikuara të prokurimit ku pagesat janë bërë gabimisht dhe t'i përcaktojnë arsyet për dështimet e identifikuara, dhe kontrollet duhet të forcohen për t'u siguruar që pagesat jo të duhura të mos përsëriten. Aty ku është e nevojshme, duhet të ndërmerret trajnim shtesë i stafit për ta mbështetur këtë proces.

[10] Pagesa në vlerë prej 2,831€ në AKPM; pagesa në vlerë 2,560€ në SR të Prizrenit; pagesa në vlerë 4,608€ në SR të Prizrenit; pagesa në vlerë prej 2,720€ në Administratën Qëndrore; dhe pagesa në vlerë prej 4,980€ në SR të Gjakovës.

11. Çështja - Çështje tjera që lidhen me prokurimin – Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura

Poashtu ne kemi identifikuar edhe një numër të çështjeve tjera që mund të kenë ndikim negativ në prokurimin efektiv:

Në SR të Gjakovës Raporti Vjetor i Kontratave të nënshkruara të prokurimit nuk kishte përmbajtje të plotë dhe të saktë. Ai përfshinte pagesat e kontratave nga vitet e mëhershme si dhe pagesat e bëra me petty cash. Vlera e raportuar prej 258,346€ nuk ka të bëj me aktivititet e prokurimit të vitit 2012.

Në kontratën për preparate (Kite) kundër virusit të Nilit Perëndimor thuhet se ato duhet të kalojnë përmes depos qëndrore. Kjo nuk ka ndodhur dhe barnat nuk ishin evidentuar në Sistemin e Informimit të Shëndetësisë (SISH). Njësoj është vepruar edhe me vaksinat e pranuara nga UNICEF për muajin shkurt në vlerë prej 264,701€.

Në SR të Prizrenit dhe në SR të Pejës pranimi i mallrave ishte bërë pavarësisht mungesës së së komisioneve të pranimit. Në të parin vlera e tyre ishte 63,471€ ndërsa në të dytin 90,548€.

Rreziku

Raportimi i gabueshëm në kontratat e prokuruara do të rezultojë në vendimarrje financiare të varfër nga menaxhmenti. Menaxhimi i varfër i stoqeve të barnave mund të rezultojë në vjedhje të artikujve dhe dështim në përdorimin efektiv të stoqeve të ruajtura. Moskontrollimi i mallrave të pranuara mund të rezultojë në pranimin e artikujve që nuk i përmbushin vëllimet dhe specifikat e kërkuara.

Rekomandimi 11

Ministri duhet të sigurojë që stafi financiar i MSH-së të punojë me SR në Gjakovë për ta përmirësuar raportimin e prokurimit, dhe me SR në Prizren dhe SR në Pejë për t'i përmirësuar pranimet e mallrave. Duhet të shqyrtohet menaxhimi i stoqeve për të siguruar që janë zbatuar proceset efektive në sigurimin e kontrollit efektiv dhe përdorimit të barnave.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Përshkrimi

Në këtë kategori janë të përfshira shpenzimet të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Kemi testuar 28 njësi mostre me vlerë prej 247,138€, duke përfshirë këtu shërbime komunale, furnizime si dhe shërbime të ndryshme.

Të gjeturat dhe rekomandimet

12. Çështja - Pagesa për trajnime, pa nënshkruar paraprakisht kontratë – Prioriteti - Tjetër

E gjetura	Kontrata për mbajtjen e trajnimeve ishte nënshkruar pas përfundimit të tyre. Vlera e saj ishte 11,667€. Pos kësaj, për njërin nga zyrtarët që merrte pjesë në trajnim, nuk ishte bërë paraprakisht kërkesa për trajnim edhe pse kjo është një kërkesë ligjore.
Rreziku	Nënshkrimi i kontratës pasi të kryhet shërbimi mund të rezultojë në shpenzime të paplanifikuara dhe të rezultojë në ofrimin e shërbimeve që nuk i përmbushë standardet e kërkuara. Ndjekja e trajnimit nga stafi, pa kërkesë adekuate mund të rezultojë në marrjen e trajnimit të panevojshëm, apo në mosmarrjen e trajnimit nga ata që kanë nevojë.
Rekomandimi 12	Ministri duhet të sigurojë që kontratat për shërbime trajnimi të nëshkruhen para marrjes së shërbimit dhe të refletkojnë analiza paraprake të nevojave për trajnim të stafit të MSH-së. Pjesëmarrja e stafit në trajnime duhet të miratohet nga menaxhmenti.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar. Kontrollet që operojnë në nivelin lokal nga MSH kanë të bëjnë me listën e pagave dhe kalkulimin dhe miratimin e shtesave të ndryshme. Numri aktual i të punësuarve është 7,251 gjersa numri i lejuar/i miratuar i tyre është 7,265.

Gjatë auditimit ne kemi testuar 108 njësi mostre, të cilat në përgjithësi i kanë takuar fushës së kujdestarive për stafin e mjekëve specialistë, por edhe proceset e tjera të cilat lidhen me fushën në fjalë. Testimet tona kanë venë ne pah mangësitë në vijim.

13. Çështja - Evidencat dhe autorizimi i kujdestarive - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura

I kemi shqyruar pagesat e kujdestarive për Mjekët Specialistë në Klinikat të cilat kanë vëllim të madh të punës dhe në të cilat ofrohen shërbime 24 orëshe. Në klinikën e Gjinekologjisë (4 raste), të Radiologjisë (11 raste) dhe në klinikën emergjente (18 raste), kishte mospërputhje mes evidencave të nxjerra nga Libri i Kujdestarive dhe pagesave që iu janë bërë këtyre specialistëve.

Në repartet e SR të Gjakovës nuk janë mbajtur ditarët për regjsitrimin e e kujdestarive. Orari përcaktohet nga drejtori i repartit dhe në bazë të atij orarit procesohet lista për pagesë. SR i Gjakovës poashtu përdor alternativën e pagesës së gatishmërisë[11] mirëpo kjo nuk ishte e rregulluar me ndonjë vendim të menaxhmentit të Spitalit.

Në disa klinika (QKUK) dhe reparte (Spitalet Regjionale) autorizimin e kujdestarive, e bëjnë shefat e klinikave/reparteve të cilët janë staf shëndetësor dhe në janë duke i autorizuar pagesat e tyre në mënyrë efektive.

Rreziku

Evidencat e pakompleturara për pagesat e kujdestarisë apo të gatishmërive, të parregulluara nga menaxhmenti mund të rezultojnë në bërjen e pagesave të gabueshme. Vetë-autorizimi i pagesave paraqet konflikt të interesit dhe mund të rezultojë në pagesa mashtruese.

Rekomandimi 13

Ministri duhet të sigurojë që të gjitha njësitë po zbatojnë kontrolle efektive mbi kujdestaritë me harmonizime të rregullta në mes të punës gjatë kujdestarive dhe pagesave të bëra, dhe të siguroj që pagesat e gatishmërisë janë autorizuar nga menaxhmenti. Vetë-autorizimi i kujdestarive duhet të ndalet.

[11] Kjo do të thotë se doktorët e reparteve që kanë mungesë të stafit janë në gatishmëri brenda 5 ditëve në muaj. Të njëjtit përgjatë ditëve të gatishmërisë nuk mbajnë kujdestari.

14. Çështja - Kalkulim jokonsistent i kujdestarive –Prioriteti – Të tjera

E gjetura Kalkulimi i pagesave të kujdestarive rregullohet me Kontratën Kolektive (KK) të lidhur në mes të Ministrit dhe Federatës së Sindikalistëve Shëndetësor. Kontrata si bazë të përllogaritjes ka 174 orë pune për muaj, dhe mbi këtë fond të orëve është bërë kalkulimi i çmimores. Mbi bazën e vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 72/07/2011 të datës 13/07/2011 është nxjerrë Udhërrëfyesi mbi formën e zbatimit të KK në Sektorin e Shëndetësisë.

Nuk është përdorur një bazë e njëtrajtshme e llogaritjes së kujdestarive nëpër Institucionet Shëndetësore. Për shembull, QKUK përdorë 176 orë, ndërsa SR i Prizrenit përdor 176 dhe 184 orë (varësisht nga ajo se sa ditë kanë muajt).

Rreziku Mos aplikimi i udhëzimeve të përcaktuara rezulton në pagesa të gabueshme.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të sigurojë që stafi financiar i MSH-së të punojë me të gjitha njësitë për të siguruar që në të gjitha rastet është bërë aplikimi i kalkulimit të saktë për pagesa të kujdestarive.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Pjesa më e madhe e subvencioneve dhe transfereve përdoren për Programin e Trajtimit Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore (PTMJIPSH).

I kemi testuar 20 mostra, me vlerë të përgjithshme prej 391,400€. Testimet tona kanë treguar si më poshtë:

Të gjeturat dhe rekomandimet

15. Çështja - Mungesa e barazimeve financiare me Spitalet ku trajtohen pacientët e PTMJIPSH-Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura	Ministria subvencionon trajtimin mjekësor në institucionet shëndetësore private. Pas trajtimit mjekësor pacientët nuk sjellin ndonjë dokument/faturë për të dëshmuar nëse është kryer trajtimi dhe nëse mjetet janë përdorur për qëllimet e synuara apo kanë qenë në harmoni me parallogarinë fillestare. Kjo ndodh te rastet që trajtohen jashtë vendit.
Rreziku	Mungesa e dëshmive rreth trajtimeve mjekësore mund të rezultojë në pagesa jo të rregullta apo të gabueshme që nuk janë në vijë me qëllimin e pagesës së bërë.
Rekomandimi 15	Ministri duhet të siguroj që të zbatohen kontrolle rreth subvencioneve dhe transfereve të cilat përfshijnë konfirmim nga pacientët mbi dëshmitë në dispozicion për t'i mbështetur pagesat – së paku në bazë të mostrave.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

MSH ende nuk ka arritur të zbatojë kontrolle për siguruar menaxhim efektiv të pasurive. Edhe më tej nuk është zhvilluar një proces adekuat i mbajtjes së evidencave rreth pasurive që kanë rezultuar me nën-regjistrimin e pasurive në PVF ashtu siç është përmendur në seksionin 2.2 të këtij raporti.

Të gjeturat dhe rekomandimet

16. Çështja - Regjistri i pasurive të MSH-së – Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura	Në mes të regjistrit gjithpërfshirës të pasurive dhe regjistrave individual të njësitë e MSH-së ekzistojnë dallime. Regjistri i përgjithshëm nuk azhurnohet në baza kohore.
Rreziku	Regjistri jo i plotë i pasurive ofron një pasqyrë të gabuar të pozicionit financiar të MSH-së dhe mund të rezultojë në vendimmarrje të varfër nga menaxhmenti në lidhje me përdorimin, mirëmbajtjen dhe blerjen/ heqjen nga përdorimi të pasurive.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë që është përfshirë një aktivitet specifik në planin e punës të departmentit të financave për vitin 2013 për të siguruar një harmonizim gjithëpërfshirës në mes të regjistrit të pasurive të MSH-së dhe atyre të njësive të saj dhe për të zbatuar një proces të vazhdueshëm të harmonizimit për të siguruar mirëmbajtjen e harmonizimit.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

MSH dhe njësitë e saj vartëse nuk kanë menaxhim efikas të borxheve, me mbi 2,6 milion euro borxhe të papaguara, pavarësisht nën-shpenzimit të buxhetit.

Përshkrimi

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve të cilat janë të prezantuara në PVF të e MSH ishte në vlerë prej 2,630,046€. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2013. Pjesa më e madhe e këtyre obligimeve kanë të bëjnë me QKUK-në dhe Spitalet Regjionale (2,291,744€), ndërsa pjesa e mbetur prej 338,295€ ka të bëjë me programet tjera të MSH-së.

Të gjeturat dhe rekomandimet

17. Çështja - Menaxhimi i detyrimeve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Në Spitalet Regjionale nuk janë menaxhuar mirë dhe nuk janë raportuar me kohë obligimet e papaguara. Si rezultat i kësaj niveli i detyrimeve të pashlyera është rritur në masë të madhe. Krahasuar me PVF-të të vitit paraprak, ekziston një rrtije prej 547,937€12.

Rreziku Bartja e obligimeve mund të rezultojë në probleme buxhetore në të ardhmen pasi që shpenzimet e planifikuara do të zvogëlohen për t'i paguar obligimet ekzistuese.

Rekomandimi 17 Ministri duhet t'i shqyrtojë arsyet për nivelin ekzistues të obligimeve të papaguara dhe të zhvillojë një plan veprimi për ta zvogëluar këtë nivel.

[12]Njësitë e MSH-së që kishin më shumë borxhe në fund të vitit 2012 janë:SR i Gjilanit në fund të 2012 ka raportuar detyrime të papaguara prej 742,806€, SR i Gjakovës ka raportuar detyrime të papaguara prej 428,290€, SR i Prizrenit ka raportuar detyrime të papaguara prej 316,543€, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ka raportuar detyrime të papaguara prej 150,251€ dhe Programi i Shëndetit Mendor ka raportuar detyrime të papaguara 88,700€.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm nuk kishte arritur ti ofroj menaxhmentit siguri të mjaftueshme në lidhje me funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme në 2012. Ka hapësirë për shtim të aktivitetit të auditimit të brendshëm – në veçanti shtim të cilësisë dhe efektivitetit të raportimit dhe rolit dhe efektivitetit të komitetit të auditimit.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm në kuadër të MSH-së është i përbërë prej NJAB-së në kuadër të Ministrisë dhe një nën njësi e cila operon në kuadër të QKUK-së. Në pajtueshmëri me Planin Vjetor të Auditimit të NJAB-së për vitin 2012 njëzet e dy (22) auditime ishin finalizuar gjatë vitit. Fushëveprim i auditimeve ka përfshirë fusha të MSH-së të cilat janë vlerësuar si me rrezik të lartë si: prokurimet, të hyrat, deponimin dhe shpërndarjen e barnave dhe procedurat e shpenzimeve.

Nën Njësia në kuadër të QKUK-së,e ka planin strategjik dhe planin vjetor të aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv edhepse nuk ishin të aprovuara nga Komiteti i Auditimit. Nën Njësia e Auditimit për vitin 2012 ka finalizuar 4 raporte. Fushëveprim i auditimeve ishin fusha e furnizimit, regjistrimi dhe shpërndarja e barnave, të hyrat vetanake, shpenzimet e telefonisë fikse si dhe menaxhimi i pasurive në QKUK.

18. Çështja - Implementimi i rekomandimeve të AB dhe funksionimi i Komitetit të Auditimit – Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura Megjithëse raportet e auditimit të brendshëm kanë shpalosur dobësi në kontrollet e brendshme dhe rekomandimet e bëra për përmirësim – cilësia e raporteve lenë vend për përmirësim. Për më shumë, menaxhmentit i mbetet për t'i adresuar rekomandimet aty ku janë bërë duke i përfshirë edhe rekomandimet e QKUK-së.

Rreziku Komiteti i Auditimit (KA) gjatë 2012 kishte mbajtur vetëm një takim me NJAB , ndërsa nuk kishte mbajtur asnjë takim me Nën Njësinë e AB të QKUK-së. Bazuar në mosfunksionimin e këtij komiteti, Ministri me vendim kishte formuar komitetin e ri i auditimit në nëntor të vitit 2012. I njëjti kishte mbajtur një takim-2012.

Dobësitë në raportimin e NJAB-së e zvogëlojnë efektivitetin e punës së tyre dhe rezultojnë në mos idnetifikimin e plotë të dobësive. Mos implementimi i rekomandimeve të NJAB-së rezulton në dobësi të vazhdueshme në kontroll duke shkaktuar dobësi operative dhe humbje financiare. Një komitet joefektiv i auditimit e zvogëlon efektivitetin e qeverisjes brenda MSH-së.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të sigurojë që KA të zbatojë në mënyrë efektive detyrat dhe përgjegjësitë e tij në vitin 2013 me theks të veçantë në të siguruarit që menaxhmenti ta zhvillojë cilësinë e NJAB-së dhe të implementojë aranazhime efektive për adresimin e rekomandimeve të saj.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me kërkesat e raportimit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm. Ne kemi konkluduar që:

Kemi mundur të marrim siguri nga operimi efektiv i kontrolleve të menaxhmentit vetëm te një numër i fushave të llogarisë dhe kemi identifikuar dobësi në fusha të rëndësishme të menaxhmentit financiar. Në veçanti, kemi vërejtur që:

MSH i kishte përgatitur Pasqyrat Vjetore Financiare në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme. Pasqyrat financiare të MSH-së kishin një numër gabimesh pavarësisht sugjerimeve për përmirësimin e tyre, të bëra edhe në raportin tonë mbi PVF-të e vitit 2011 dhe memon e vitit 2012 në lidhje me pasqyrat 9 mujore. Nuk është arritur konsolidimi i plotë i të gjitha informatave financiare relevante.

MSH i ka përmbushur shumicën e kërkesave aktuale për raportim të jashtëm pos planeve të prokurimit për dy njësi të saj. Megjithatë, mbetet mundësia të aplikohen vetëvlerësimet e MFK-së për t'i vlerësuar dhe përmirësuar kontrollet e brendshme në mënyrë prokative aty ku duhet..

Megjithëse MSH i ka marrë në konsideratë rekomandimet tona të vitit të kaluar, shumica e tyre kanë mbetur për t'u adresuar tërësisht. Kjo ka rezultuar në identifikimin e dobësive që kanë vazhduar në vitin 2012.

Megjithëse MSH e ka realizuar buxhetin në një nivel të arsyeshëm, pos për investimet kapitale, mbetet mundësia për zhvillim të mëtejm të procesit buxhetor. Në veçanti, barrierat në shpenzimet për investime kapitale në kohë të ndryshme duhet të identifikohen dhe adresohen. Në lidhje me këtë, theks i veçantë duhet t'i vihet zbatimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe PIP ashtu siç është parashikuar.

Edhepse të hyrat janë relativisht të ulëta në krahasim me shpenzimet, është e rëndësishme të zbatohen kontrolle të shtuara për ta mbështetur menaxhimin më të mirë. Këto përfshijnë procese të përmirësuara të harmonizimit dhe fokus më të madh në plotësinë e dëftesave. Kjo mund të mbështetet duke e zbatuar një zgjidhje softverike por poashtu mund të adresohet përmes kontrolleve të shtuara manual.

Megjithëse meanxhmenti i MSH-së e kupton rëndësinë e kontrolleve efektive të shpenzimeve, ekzistojnë dobësi në këtë fushë. Këto kanë të bëjnë në veçanti me prokurimin mirëpo poashtu ndikojnë në shpenzimet tjera, pagat dhe subvencione e transfere.

MSH ende nuk ka arritur të zbatojë kontrolle për siguruar menaxhim efektiv të pasurive. Edhe më tej mungon një proces adekuat i mbajtjes së evidencave rreth pasurive që kanë rezultuar me nën-regjistrimin e pasurive në PVF.

MSH dhe njësitë e saj vartëse nuk kanë menaxhim efikas të borxheve, me borxhe të papaguara mbi 2,6 milion euro pavarësisht nën-shpenzimit karshi buxhetit.

Sistemi i auditimit të brendshëm nuk kishte arritur t'i ofrojë menaxhmentit siguri të mjaftueshme në lidhje me funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme në 2012. Ka hapësirë për shtim të aktivitetit të auditimit të brendshëm – në veçanti shtim të cilësisë dhe efektivitetit të raportimit dhe rolit dhe efektivitetit të komitetit të auditimit.

Siç është potencuar edhe në përmbledhjen ekzekutive MSH është në proces të implementimit të një reforme rrënjësore. Kjo pritet të qartësoj edhe më shumë linjat e komunikimit dhe të llogaridhënies,dhe poashtu të ndihmoj në tejkalimin e sfidave dhe problemeve aktuale në menaxhimin e aktiviteteve administrative si dhe shëbimeve shëndetësore. Ne inkurajojmë Ministrin të vazhdoj realizimin e kësaj reforme.

Pasi që struktura e re organizative akoma nuk është adaptuar, ne të gjitha rekomandimet ja kemi adresuar Ministrit. Pas adaptimit të strukturës, përgjegjësinë për implementimin e rekomandimeve që ndërlidhen me to, Ministri do të duhej ta bart tek drejtuesit apo organet përgjegjëse të njësive të reja.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuara të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistonte (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve**. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund **të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustifikuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinioni që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1 Rezultati Financiar ne krahasim me buxhetin e aprovuar	Ekzekutimin dhe monitorimin e procesit të shfrytëzimit të buxhetit sipas periudhave të parapara kohore, dhe Rishikimin dhe analizimin e realizimit të buxhetit te investimeve kapitale, në veçanti në tremujorin r fundit			Ky rekomnadim nuk eshte plotesuar ende, edhe ketë vit kemi vërejtur mangësi në shpenzimet e fundvitit.
2 Te hyrat	Strukturat shëndetësore të bëjnë: -Evidentimin, barazimin dhe raportimin e plotë të të hyrave dhe shpenzimeve në nivelin qendror dhe tek njësitë vartëse të saj, -Për më tepër të iniciohet auditim i brendshëm për proceset e inkasimit në njësitë vartëse që nuk janë mbuluar nga auditimi ynë.		Pika e parë e rekomandimit nuk është adresuar plotësisht, ndërsa pika e dytë është adresuar. MSH kishte inicuar auditimin në lidhje me ketë aktivitet.	

3 Paga dhe mëditje	• Vendimet që kanë të bëjnë me shtesat e pagave për stafin, të jenënë harmoni me fondet e Ministrisë dhe trajtimin e tyre me Ministrinë e Financave,siç parashihet edhe me Rregullat Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit.	MSH në kordinim me MF ka përfshi në projeksionet buxhetore impaktin e pagesave të kujdestarive.		
4 Shpenzimet/prokurimit	• Ngritjen e kapaciteteve brenda zyres së prokurimit, dhe analizimin e gjendjes për nevojën e centralizimit në menaxhimin e proceseve të prokurimit; • Instalimin e mekanizmave të kontrollit në QKUK dhe Spitalet Regjionale, dhe monitorimin e procesit të prokurimit; • Që funksioni i auditimit të brendshëm lidhur me proceset e prokurimit është përfshi në çdo njësi vartëse të MSH-së; • Konsistencën e projekteve për investime publike (PIP) prej viti në vit në harmoni me legjislacionin buxhetor, dhe monitorim të progresit të tyre; dhe • Që projektet të përcillen dhe të realizohen me kohë dhe pagesat të kryhen pasi të jetë kryer shërbimi. Gjithashtu, të evitohen shpenzimet e panevojshme për barna të LE kur të njëjtat gjenden në Depon Qendrore të MSH.		Nuk kemi vërejtur se QKUK dhe SR kanë ndërmarrur aktivitete substanciale në monitorimin e proceseve të prokurimit Poashtu MSH ende nuk kishte arritur të bëj harmonizimin e projekteve kapitale e as përcjelljen dhe vlerësimin e shpenzimeve të mëdha në tremujorin e fundit MSH ende nuk ka krijuar mekanizma te cilët në mënyrë efektive përcjellin realizimin e projekteve.	

5 Blerjet tjera	• Pranimi dhe pagesa e faturave të bëhen në harmoni me kushtet ligjore, dhe të konsiderohet plotësia dhe verifikimin për shërbimet e kryera apo artikujt e faturuar; dhe • Pagesat lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional dhe shtesat tjera për ngritjen akademike të stafit, janë trajtuar në pajtueshmëri me kornizën financiare.			
6 Menaxhimi i stokut farmaceutik	• Regjistrimin e stokut farmaceutik sipas kartelës për çdo njësi dhe harmonizimin e tyre me ekzistencën fizike të tyre; • Të gjitha barnat janë të identifikuara me banderolat përkatëse, në mënyrë që të evitohen mundësitë e keqpërdorimeve; • Blerjen e barnave duke marrë në konsideratë afatet e skadencës; • Komisioni për pranimin e barnave ka në përbërje dhe zyrtarin e prokurimit; dhe • Respektimin e metodës FEFO, për sa i takon distribuimit të barnave.			Vazhdon gjendje e njëjtë me menaxhimin e barnave.

7 Subvencionet dhe Transferet	Rishikimi i politikave lidhur me funksionin dhe zbatimin e programeve të veçanta në këtë rast "Programit për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike" në mënyrë që të jenë të harmonizuara me ligjet përkatëse.	MSH kishte përmiresuar aktivitet në lidhje me PTMJIPSH në masë optimale.		
8 Çertifikimi i pagesave	• Çertifikimi i pagesave duhet të forcohet dhe regjistrimi në kode dhe programe adekuate; dhe • Të analizoj çështjen e obligimeve tatimore të operatorit "Shimadzu d.o.o" nga Kroacia në bashkëpunim me ATK-në. Tatimet e pa paguara t'i kthehen Buxhetit të Kosovës.			Edhe ketë vit janë përcjellur gabime në çertifikimin e pagesave.
9 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	• Trajtimin e të gjitha shpenzimeve kapitale në mënyrë të duhur, duke kapitalizuar vlerat e pasurive si dhe të bëj regjistrimet e duhura kontabël; • Që njësitë vartëse të MSH: QKUK Spitalet Regjionale edhe AKPM, të funksionalizojnë komisionet për evidentimin e gjithë inventarit sipas poseduesve të tyre; dhe • Formimin e një komisioni qendror në MSH për evidentimin dhe vlerësimin e pasurisë dhe harmonizimin e informatave me gjitha nivelet lokale të saj.			Rekomandimi nuk ishte adresuar